

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E
SHKENCËS BYROJA E
ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



Programi mësimor

**SHOQËRIA
për klasën I**

Shkup, viti 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Shoqëri
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (parë)
Temat	<ul style="list-style-type: none"> • Unë jam fëmijë • Unë jam nxënës • Shtëpia ime • Vendi në të cilin jetoj
Numri i orëve	1 orë në javë /36 orë në vit
Pajisje dhe mjete	<ul style="list-style-type: none"> • Kompjuter dhe projektor. • Videoincizime dhe/ose fotografi nga festat e ditëlindjeve. • Materiale zbukuruese (p.sh. balona (tullumbace) me forma, ngjyra dhe madhësi të ndryshme). • Fotografi/ilustrime për muajt e vitit. • Shiriti kohor i ngjarjeve gjatë një jave dhe shiriti kohor për faktin se ç'bëjmë në mëngjes, gjatë ditës, në mbrëmje dhe gjatë natës. • Lojëra me bashkim figurash dhe ilustrime me fytyra të njerëzve që shprehin emocione të ndryshme. • Ilustrime për mbështetje të përmbajtjeve/aktiviteteve të ndërlidhura me shtëpinë dhe familjen/bashkësinë. • Lodra për mbështetje të përmbajtjeve/aktiviteteve (vegla kopshtare, mjete për higjienë personale dhe higjienë në shtëpi, mobilie, kube për konstruktim). • Rekuizita: semafor, shenja stop, uniforma, stetoskop, mjete të mjekut dhe lodra të tjera të këtij lloji. • Audio – ose videomaterial me incizim të zërit (sirena) të veturës policore, autoambulancës dhe zjarrfikëse. • Lodra – automjete: ambulance, zjarrfikëse dhe policore ose fotografi të tyre.
Normativi i kuadrit arsimor	<p>Punën edukativo-arsimorë në klasën e parë mund ta realizojë personi i cili është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • profesor/arsimtar/mësues i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KKM) dhe 240 SETK; • profesor/edukator i edukimit parashkollor, VII/1 ose VI/1 (sipas KKM) dhe 240 SETK; • pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KKM) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARTET NACIONALE

Rezultatet e mësimit të paraparë me programin mësimor, synojnë arritjen e kompetencave në vijim të përfshira në fushën e shoqërisë dhe të kulturës demokratike të standardeve nacionale:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:</i>	
VI-A.2	të analizojë sjelljen e tij me qëllim që të përmirësohet, duke vendosur qëllime reale dhe të realizueshme për veprim aktiv në bashkësi;
VI-A.3	të formulojë dhe të argumentojë pikëpamjet e tij, t'i dëgjojë dhe t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe me respekt të sillej ndaj tyre edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve sipas çdo lloji (gjinisë dhe përkatësisë etnike, moshës, aftësive, statusit social etj.);
VI-A.6	të njohë prezencën e stereotipave dhe të paragjyqimeve të vetja dhe të tjerët dhe të kundërvihet ndaj diskriminimit;
VI-A.7	të njohë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i parashohë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojë atë;
VI-A.11	të zbatojë normat dhe rregullat për pjesëmarrje të sigurt në trafik;
VI-A.13	të analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, të identifikojë rastet e shkeljes së të drejtave dhe të ndër marrë aktivitete për respektimin joselektiv të tyre;
VI-A.22	të identifikojë dhe të respektojë të gjitha simbolet nacionale të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të manifestojë ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B. 1	nuk duhet të bëhet diskriminimi në bazë të dallimeve midis njerëzve (gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, aftësive, statusit social etj.);
VI-B. 2	të gjithë njerëzit duke përfshirë edhe fëmijët, kanë të drejtë t'i shfaqin mendimet dhe qëndrimet e tyre dhe të marrin pjesë në sjelljen e vendimeve të cilat lidhen me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B. 8	çdo qytetar është i detyruar t'i respektojë ligjet, normat dhe rregullat të cilat e rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve;
VI-B. 13	identiteti nacional, i cili del nga përkatësia e shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është komponentë e rëndësishme e identitetit të të gjithë qytetarëve të shtetit.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të fushave të mëposhtme të standardeve nacionale si: **shkrim-leximi digjital, zhvillimi personal dhe social, teknika, teknologjia dhe sipërmarrja dhe të shprehurit artistik dhe kultura.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre nevojitet përdorimi efektiv i TIK-ut për të zgjidhur një detyrë/problem;
IV-A.5	të përcaktojë çfarë informacionesh janë të nevojshme, të gjejë, të zgjedhë dhe të marrë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje;

V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të tij, i cili ndërtohet në bazë të përkatësisë së grupeve të ndryshme sociale (p.sh. gjinisë, identitet etnik dhe nacional) dhe roleve të ndryshme që i ka në jetë (p.sh. nxënës, djalë/vajzë);
V-A.4	të vlerësojë aftësitë e tij personale dhe arritjet (duke i përfshirë anët e forta dhe të dobëta) dhe në bazë të tyre të përcaktojë prioritetet të cilat do t'i mundësojnë zhvillimin dhe përparimin;
V-A.5	të njohë emocionet te vetja dhe te të tjerët, t'i parashohë pasojat si rezultat i reaksioneve të tij emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të vendosë qëllime për të mësuar dhe për t'u vetëzhvilluar dhe të punojë për t'i tejkaluar sfidat të cilat paraqiten gjatë arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale që ta lehtësojë mësimin dhe ta përshtatë sjelljen individuale në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën e tij në mënyrë që do t'i mundësojë me efikasitet dhe efektivitet t'i realizojë qëllimet e vendosura dhe t'i përmbush nevojat personale;
V-A.9	t'i parashoh pasojat e veprimeve të veta dhe të të tjerëve për vetveten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike në vlerësimin e së drejtës dhe të gabuarës në veprimet e tij dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtutshme të karakterit (ndershmëri, drejtësi, respekt, durim, kujdes, mirësjellje, mirënjohje, vendosmëri, guxim dhe vetëdisiplinim);
V-A.12	me sukses të ballafaqohet me presione sociale;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantohet duke u përshtatur me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'ishpreh shqetësimet dhe nevojat e tij në mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet individuale dhe nevojat e tyre me të tjerët duke marrë parasysh edhe pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion kthyes dhe mbështetje për veten, por edhe të japë informacion kthyes konstruktiv dhe mbështetje në dobi të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të sjellë përfundime dhe të marrë vendime racionale;
VIII-A.7	të njohë dhe të sqarojë se si monumentet kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme.

<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.2	vetëdijesimi i identitetit personal kontribuon në përfundimin e vetëbesimit dhe në zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet personale dhe mirëqenia në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo investon dhe nga rezultatet që i arrin;
V-B.4	çdo veprim që ndërmer ka pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për t'i përmbushur interesat dhe nevojat e tyre personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive çojnë në përparim të planit individual dhe social;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe se është e nevojshme të shfrytëzohen me përgjegjësi.

REZULTATET E MËSIMIT

Tema: UNË JAM FËMIJË

Gjithsej orë: 12

Rezultatet e mësim:

nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të prezantojë veten para të tjerëve;
2. të njohë, të dallojë ndjenjat themelore të vetja dhe të tjerët;
3. të përshkruajë tiparet e dëshiruara dhe sjelljen, karakteristike të shoqërim;
4. numëron dhe bën dallimin e muajve të vitit dhe ditëve të javës, bën dallim midis të tashmes (sot) në krahasim me të kaluarën e afërt dhe të largët (dje dhe kur isha i/e vogël) dhe të ardhmes (nesër dhe kur do të jem i madh/e madhe).

Nxënësi/nxënësja do të:

5. zhvillojë fotografi pozitive për veten (vetëbesim dhe vetërespekt).
6. kundërshtim ndaj sjelljes (veprimeve) korruptive.

Përmbajtja (nacionet)	Standardet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> Kush jam unë (fëmijë, djalë, vajzë, emër, mbiemër, adresa, data e lindjes, ditëlindja, muajt e vitit). 	<ul style="list-style-type: none"> prezanton veten, duke treguar emrin dhe mbiemrin, adresën dhe vendin ku jeton si dhe datën dhe vendin e lindjes dhe identifikohet sipas gjinisë (si djalë apo si vajzë) dhe moshës. shpjegon ditëlindjen si dita kur është lindur. ilustron të festuarit e ditëlindjes nëpërmjet shembullit. vëren ngjashmëri dhe dallime me të tjerët në paralele në raport me adresën dhe vendin ku jeton. numëron muajt e vitit duke respektuar radhitjen e tyre. dallon se kush në paralele ka lindur më herët dhe kush më vonë gjatë vitit (sipas radhitjes së muajve të vitit).
<ul style="list-style-type: none"> Çka mundem tash dhe çka do të mundem në të ardhmen. Çka më pëlqen te vetja (tipare pozitive, i ditur, e tashmja, e kaluara, e ardhmja, ditët e javës, sot, dje, nesër). 	<ul style="list-style-type: none"> përmend tipare pozitive te vetja e tij dhe i krahason me tiparet pozitive të të tjerëve. dallon të tashmen nga e kaluara dhe e ardhmja në rrjedhën e jetës së tij dhe e njuh rëndësinë e organizimit të kohës. përshkruan çka mundet dhe di tash, çfarë ka mundur dhe ka ditur në të kaluarën dhe çka do të dëshironte të bënte dhe të dinte në të ardhmen. i tregon ditët e javës dhe i identifikon se cila ditë i paraprin dhe pason. saktësisht i zbaton nocionet dje, sot, nesër. përshkruan çfarë ka mësuar të re të bëjë në raport me ditën e djeshme dhe javën e kaluar, dhe çka do të dëshironte të mësonte të bëjë nesër dhe javën e ardhshme. shpjegon se si fëmijët (duke e përfshirë edhe veten) gradualisht i zhvillojnë shkathtësitë dhe aftësitë e tyre. shpjegon se si të investuarit në punë çon në përvetësimin e asaj që e di dhe atë që mund ta dijë. identifikon aktivitete korruptive dhe e tregon anën negative të tyre.
<ul style="list-style-type: none"> Ndjenjat e mia (gëzimi, pikëllimi, frika, hidhërimi, dashuria). 	<ul style="list-style-type: none"> njuh dhe tregon ndjenjën e gëzimit, pikëllimit, frikës dhe hidhërimit te vetja dhe te të tjerët. njuh situata nga jeta e përditshme të cilat nxisin dhe manifestohen me ndjenjat e gëzimit, pikëllimit, frikës dhe hidhërimit. përshkruan se si ndjehet dhe çka bën kur është i/e gëzuar, pikëlluar, frikësuar dhe nevrikosur. njuh mënyrat e ndryshme të manifestimit të dashurisë (me fjalë, nëpërmjet lëvizjeve dhe veprimeve). shpjegon rëndësinë e manifestimit të dashurisë për të afërmit në mjedisin që e rrethon.
<ul style="list-style-type: none"> Shokët dhe shoqet e mija (shok/shoqe, shoqëri). 	<ul style="list-style-type: none"> njuh dhe tregon tiparet e shokëve të mirë. përshkruan veprimet të cilat janë karakteristikë e shoqërimit (në shkollë, te fqinjët). tregon lojëra të ndryshme me shokët të cilat çojnë në përforcim të shoqërisë.

Shembuj të aktiviteteve:

- çdo nxënës nëpërmjet lojës interaktive e thotë emrin dhe mbiemrin e tij si dhe adresën ku jeton, kurse të gjithë të tjerët pasi ta dëgjojnë thonë “tungjatjeta” dhe e përsërisin vetëm emrin e tij/sajë.
- nxënësit nëpërmjet lojës e thonë datën e lindjes dhe radhiten në vijë sipas muajit në të cilin kanë lindur.
- mësimdhënësi organizon festë “fiktive” të ditëlindjes në klasë nëpërmjet së cilës nxënësit mësojnë për mënyrën e organizimit të festave (ftesa, rregullimi i ambientit) dhe sjelljes në to (si urohet, si dhurohen/pranohen dhuratat).
- nxënësit në shirit kohor prej një jave, vizatojnë ngjarje që ju kanë ndodhur gjatë javës.
- nxënësit me ndihmë të mësimdhënësit nëpërmjet bisedës dhe lojës përgjigjen në pyetjet “Çka mundem?”, dhe pastaj diskutojnë duke u përgjigjur në pyetjen “Çka do të bëj?”.
- nxënësit e ulur në rreth tregojnë çka kanë ditur të bëjnë më parë kur kanë qenë 3-4 vjet dhe çka kanë mësuar tani dhe përgjigjen në pyetjet se a janë rritur vetëm në gjatësi dhe në peshë ose kanë vërejtur se kanë ndryshuar edhe në sjellje dhe njohuritë që i kanë fituar.
- mësimdhënësi me nxënësit organizojnë lojë për vetëprezantim, të cilët pasi të shihen në pasqyrë vetëprezantohen dhe thonë diçka të bukur për veten.
- mësimdhënësi udhëzon lojë të cilën nxënësit e realizojnë nëpërmjet imitimit të ndjenjave të ndryshme dhe vizatojnë emotikonë në tabelë me gjendjet përkatëse emotive, përshkrim të situatave në të cilat i shprehin ndjenjat, mësojnë për empatinë dhe komunikimin verbal dhe jo verbal.
- loja – mësimdhënësi tregon ndjenjë, kurse nxënësit duhet ta tregojnë në fytyrat e tyre.
- mësimdhënësi e lexon fabulën e Ezopit për dhelpërën dhe korbin. Pastaj nxënësit e aktrojnë dhe në fund diskutojnë se si me ndihmën e lavdërimit të paarsyeshëm arriti t’ia rrëmbejë djathin korbit. Qëllimi është që të konstatohet se nuk duhet të gënjehet edhe atëherë kur nga gënjeshtria mund të ketë përfitim.
- mësimdhënësi e përshtat fabulën për lepurin dhe breshkën (breshka i jep lepurit karotë që të lëshojë të fitojë në garën e tyre dhe lepuri e pranon atë) Fabulën e adaptuar me ndihmë të ilustrimeve ua prezanton nxënësve. Pasi ta aktrojnë, nxënësit diskutojnë për arsyeshmërinë/joarsyeshmërinë e veprimeve të breshkës dhe të lepurit. Qëllimi është që të dënohet veprimi, sjellja e breshkës (dhënia e karotës për shfrytëzim, për përfitim) dhe sjellja e lepurit (pranimi i karotës për të arritur përfitim).
- nxënësit nëpërmjet lojës interaktive e paramendojnë shokun/shoqen më të mirë, e vizatojnë dhe tregojnë se çka ju pëlqen/nuk ju pëlqen tek ai/ajo dhe tregojnë nga një ngjashmëri dhe diçka në çka janë të ndryshëm mes tyre.
- mësimdhënësi organizon lojë nëpërmjet së cilës nxënësit sipas zgjedhjes vendosin çka më shumë dëshirojnë të luajnë me shokët/shoqet e tyre dhe çka kanë bërë diçka të mirë për shokun/shoqen e tyre, kurse kur gabojnë (e pranojnë dhe e falin –me fjalë dhe përqaftim).

Tema: **UNË JAM NXËNËS**

Gjithsej orë: **8**

Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. identifikohet vetë si nxënës/nxënëse dhe e ndjen shkollën si mjedisin e vetë për të mësuar;
2. shpjegon përgjegjësitë e mësimit dhe të nxënësve në procesin e mësimit dhe rolin e shkollës si mjedis për mësime dhe shoqërim;
3. përshkruan dhe zbaton rregullat e sjelljes në klasë, në shkollë dhe në oborrin e shkollës të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen e higjienës dhe sjelljen jo të dhunshme.

Nxënësi/nxënësja do të pranojë se:

4. shkolla është vend ku së bashku mësojnë, shoqërohen dhe midis tyre respektohen fëmijët që janë të ndryshëm në bazë të (gjinisë, përkatësisë etnike, pamjes fizike, aftësive/mundësive, statusit social).

Përmbajtja (nacionet)

Standardet e vlerësimit:

- Klasa dhe shkolla jonë

(klasa, shkolla, oborri i shkollës, tualeti, zyra, biblioteka, mensa, koshi i mbeturinave), patronati.

- prezanton veten si nxënës/se dhe e tregon paralelen dhe shkollën në të cilën mëson.
- përshkruan organizimin hapësinor të klasës dhe e shpjegon se klasa si hapësirë e përbashkët është e të gjithë nxënësve të paraleles (duke përfshirë edhe veten).
- shpjegon rolin e shkollës si mjedis për të mësuar dhe për t'u shoqëruar.
- shpjegon rolin e nxënësve për kujdesje në rregullimin, rregullin dhe higjienën në klasë.
- përshkruan rrugën midis klasës dhe oborrit të shkollës, si dhe hapësirat e tjera të rëndësishme në shkollë.
- tregon rregullat për mbajtje të higjienës personale gjatë shfrytëzimit të tualetit dhe mensës dhe mirëmbajtjen e këtyre hapësirave.
- shpjegon rolin e nxënësve në mbajtjen e higjienës në shkollë dhe në oborrin e shkollës.
- tregon rregullat e sjelljes në klasë, në shkollë dhe në oborrin e shkollës (ndalimi i vrapimit nëpër korridore/shkallë, përdorimi i fjalëve fyese, sjellja agresive ndaj shokëve të klasës) dhe mënyrat e respektimit të tyre.
- tregon datën se kur festohet patronati i shkollës dhe shpjegon çka paraqet patronati.

- Ne nxënësit dhe mësimit dhe mësimit dhe mësimit (nxënës/nxënësja, mësimit dhe mësimit).

- përshkruan rolin e mësimit dhe mësimit si person i/e detyruar t'ju ndihmojë nxënësve të mësojnë atë çka kërkohet në lëndë të ndryshme dhe të mësojnë punë të tjera të cilat janë të rëndësishme për jetën në shkollë dhe jashtë shkollës.
- përshkruan rolin e nxënësve, duke përfshirë edhe veten si përgjegjës për t'i respektuar udhëzimet e mësimit dhe mësimit për atë se çka dhe si të mësojnë.
- krahason përgjegjësinë e mësimit dhe mësimit dhe të nxënësve –mësimit dhe mësimit të mundohen t'i mësojnë nxënësit, kurse nxënësit të mundohen të mësojnë.

Shembuj të aktiviteteve

- shqyrtimi i hapësirave shkollore (tualetet, mensa, biblioteka, zyra e mësimitdhënësve, e drejtorit, e bashkëpunëtorëve profesional) dhe tregohet se cili është funksioni i tyre.
- mësimitdhënësi organizon lojë (p.sh “Me shkronjën, me shkronjën...”) nëpërmjet së cilës nxënësit qëllojnë objekte nga klasa dhe në këtë mënyrë njihen me hapësirën (materialet dhe mjetet për punë, mjetet vizuale, objekte zbuluese, lodrat etj.)
- mësimitdhënësi bashkë me nxënësit e rregullojnë klasën, këndet, panotë etj.
- mësimitdhënësi përgatit lojë me bashkim figurash me fotografi të shkollës ose klasës kurse nxënësit e rregullojnë atë (punë në çift ose grupe të vogla).
- nxënësit (në grupe të vogla) bëjnë vizatim të përbashkët të shkollës dhe oborrit të shkollës – një se si duken në moment dhe një tjetër se si do të dëshironin të dukeshin; i prezantojnë para të tjerëve dhe tregojnë për dallimet në ilustrimet midis gjendjes aktuale dhe asaj të dëshiruar.
- nxënësit në grupe të vogla bëjnë vizatim të përbashkët të klasës – një se si duket një klasë e rregulluar dhe një tjetër se si do të dukej klasa kur do të ishte e papastër dhe e parregulluar. I paraqesin vizatimet para të tjerëve dhe tregojnë për dallimet e ilustrimeve të ndërës situatë dhe tjetrës.
- diskutim për rëndësinë e patronatit të shkollës dhe sjellje të vendimit në grup për mënyrën e shënimit në paralele në të cilën do të marrin pjesë të gjithë nxënësit.
- çdo nxënës hedh diçka nga mjetet e tij në dysheme nën bankën e tij dhe një fletë të bërë në formë të topit e hedh në anën tjetër të klasës, pas kësaj të gjithë nxënësit duke lëvizur nëpër klasë, ndihmojnë për t’i mbledhur të gjitha objektet e hedhura dhe çka duhet t’i hedhin në koshin e mbeturinave; diskutohet për përgjegjësitë e tyre që të mos hedhin qëllimisht mbeturina, por edhe për faktin se duhet t’i mbledhin kur të shohin diçka të hedhur në dysheme.
- diskutim në grup se si e mendojnë një mësimitdhënës/e të mirë – çka presin nga ai/ajo që duhet të bëjë gjatë orës dhe si të sillen me to. Para të tjerëve e prezantojnë atë që kanë menduar.
- luajtje rolesh: nxënësi dhe mësimitdhënësi (nxënës i mirë/jo i mirë dhe mësimitdhënës i mirë/jo i mirë) dhe diskutim për atë se si duan të jenë dhe pse.
- diskutim me nxënësit për atë se cilat sjellje në klasë dhe/ose shkollë janë të dëshiruara dhe cilat nuk janë. Përveç identifikimit të sjelljeve, nga nxënësit kërkohet të tregojnë pse i mendojnë si të tilla.
- nga vizatimet e situatave të cilat ilustronë ndalimin e sjelljeve në klasë dhe/ose shkollë (p.sh. nxënës të cilët gjuhen me objekte, grup fëmijësh të cilët nxitojnë nëpër shkallë/korridore, nxënës i cili rrëzohet nga shkallët, nxënës i cili e godet/shtynë një nxënës tjetër, fëmijë të cilët e ofendojnë një fëmijë tjetër, fëmijë që hedh mbeturina në tokë, fëmijë që hedh mbeturina në koshin e dedikuar për shishe plastike) të siguruar nga mësimitdhënësi/ja, nxënësit (të ndarë në grupe të vogla) bëjnë poster, duke i paraqitur si në shenjë komunikacioni për ndalim; posterat vendosen në një mur të klasës.
- mësimitdhënësi i organizon nxënësit të luajnë role nëpërmjet së cilës do të tregojnë sjellje të ndryshme në situata të ndryshme në shkollë dhe pastaj vlerësojnë se vallë sjellja e paraqitur është sipas rregullave të vendosura.

- diskutim për atë se cilat janë pasojat nga mosrespektimi i rregullave dhe vendimmarrje në grup për masat që duhet ndërmarrë nëse dikush nuk i respekton ato rregulla.

Tema: **SHTËPIA IME**

Gjithsej orë: **8**

Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. identifikojë veten si anëtar i familjes/bashkësisë;
2. shpjegoj rolin dhe përgjegjësitë e fëmijëve dhe të rriturve në familje/bashkësi;
3. dallojë kohën e lirë nga koha e përkushtuar për angazhimet në familje dhe shkollë.

Përmbajtja (nacionet)

Standardet e vlerësimit:

<ul style="list-style-type: none"> • Shtëpia dhe familja (shtëpi/banesë, hapësirat në shtëpi, oborr, familje, prind/prindër, tutor/tutorë, fëmijë, nënë, babë, vëlla, motër, gjyshe, gjysh, farefis...). 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shtëpinë dhe i identifikon hapësirat në të dhe shpjegon për çka shfrytëzohen. • tregon anëtarët e familjes së tij, përkatësisht anëtarët e bashkësisë me të cilët jeton. • përshkruan raportet midis anëtarëve të familjes/bashkësisë në të cilën jeton (prindër–fëmijë, tutorë(kujdestarë) – fëmijë, vëllezër/motra). • shpjegon dallimin midis familjeve (familje me një ose dy prindër dhe me një ose më shumë fëmijë, me prindër që jetojnë të ndarë, familje e zgjeruar, familje tutorë, familje për kujdesje).
<ul style="list-style-type: none"> • Role dhe përgjegjësit në shtëpi (kujdes, të rritur, detyrime, respekt, përgjegjësi, higjienë). 	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rolin e të rriturve në përkujdesjen e shtëpisë dhe fëmijëve. • tregon dhe i shpjegon hapat për mbajtjen e higjienës personale duke mbajtur përgjegjësi në shfrytëzimin e ujit. • identifikon ku hidhen mbeturinat e amvisërisë. • shpjegon rolin e tij dhe rolin e anëtarëve të familjes në mbajtjen e higjienës në shtëpi. • dallon detyrimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe të fëmijëve në familje/shtëpi. • shpjegon se edhe anëtarët femra dhe meshkuj të familjes janë njëloj përgjegjës për kujdes të shtëpisë (për mbajtjen e higjienës, për gatimin etj.). • dallon veprime të cilat kontribuojnë në respektimin e ndërsjellë të anëtarëve të familjes/bashkësisë dhe jetës së përbashkët nga veprime që e prishin atë.
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet ditore (mëngjes, gjatë ditës, mbrëmje, gjatë natës, kohë e lirë, lojëra). 	<ul style="list-style-type: none"> • tregon aktivitetet e anëtarëve të familjes/bashkësisë gjatë ditës, duke përfshirë edhe të tija. • tregon shembuj të shfrytëzimit të kohës së lirë (nëpërmjet lojës, duke lexuar, duke shikuar TV, vizatuar, lojëra të përbashkëta me të tjerë, sport, punë në oborr, ecje...). • shpjegon se si duhet të organizohet koha e lirë (lojëra me shokë/shoqe, shikimi i TV-së, dëgjim muzike, lojëra kompjuterike, aktivitete të tjera të lira...) për tu përmbushur nevojat për lojë, por edhe përgjegjësitë që lidhen me shtëpinë dhe shkollën.

Shembuj të aktiviteteve:

- mësimdhënësi paraqet hapësira të ndryshme të shtëpisë, kurse nxënësit identifikojnë se cili është funksioni i tyre.
- nxënësit vizatojnë kosh për mbeturina, një të dedikuar për letra dhe një për plastikë. Nxënësit të ndarë në grupe, pranojnë fotografi me mbeturina nga letra dhe plastika (p.sh. vizatim të një shishe plastike, ambalazh letre për lëngje, gota plastike, kuti prej kartoni) dhe duhet t'i radhisin dhe t'i ngjisin mbi vizatimin e koshit në të cilin duhet të hidhen.
- nxënësit të ndarë në grupe duhet të konstruktojnë shtëpi (ndërtojnë shtëpi nga kube druri), e mbushin me mobilie (lodra) dhe i ndajnë detyrat për ta sistemuat. Gjatë kohës së aktiviteteve kanë kujdes në raportet e ndërsjella dhe respektin.
- mësimdhënësi prezanton fotografi të fëmijëve, meshkujve edhe femra të moshave të ndryshme në çdo lloj roli lidhur me detyrat në shtëpi (fëmijë, burrë dhe grua duke pastruar, larë, larë enët, përgatitur ushqim, bëjnë pazar, rregullojnë oborrin/kopshtin, kujdesen për kafshët, bëjnë rikonstruktim (rregullojnë etj.), kurse nxënësit i lidhin me aktivitetet e anëtarëve të familjes/bashkësisë së tyre. Pastaj diskutojnë për stereotipat e roleve gjinore në shtëpi.
- nxënësit në grupe të vogla marrin vizatime/fotografi në të cilat veçmas janë paraqitur burra, gra dhe fëmijë të moshave dhe gjinive të ndryshme. Secili nxënës zgjedh fotografi që të paraqes anëtarët e "familjes së tij" dhe i thotë emrat e të gjithë anëtarëve. (Alternativa është secili nxënës të bëjë kolazh me fotografi në të cilin janë paraqitur anëtarët e familjes/bashkësisë në të cilën jeton).
- mësimdhënësi prezanton videomateriale me lloje të ndryshme të familjeve/bashkësive (p.sh. familje vetëm me një prind/tutorë, familje me më shumë fëmijë, bashkësi me gjyshër, familje nën përkujdesje), kurse nxënësit e identifikojnë familjen/bashkësinë e tyre.
- mësimdhënësi organizon lojë me luajtje të roleve në të cilat nxënësit prezantojnë situata të mosrespektimit të ndonjë anëtari të familjes/bashkësisë (p.sh. baba nuk lejon fëmijën të shikojë film vizatimor, pasi që do të shohë futboll; fëmija dëgjon muzikë me zë të lartë derisa nëna punon në kompjuter) dhe pastaj i kthejnë në situata të cilat tregojnë respekt.
- mësimdhënësi organizon lojë ku nxënësit paraqesin situata nga shtëpia kur kanë qenë më të lumtur dhe çfarë dëshirojnë të bëjnë më shumë me shtëpitë (familjet) e tjera.
- nxënësit në grupe të vogla vizatojnë hapësira të pasistemuara në shtëpi, i paraqesin para të tjerëve dhe tregojnë kush më shumë ka kontribuar për situatën e tillë dhe çka duhet të bëhet që ajo të rregullohet.
- nxënësit radhisin vizatime/fotografi të aktiviteteve ku anëtarët e ndryshëm të familjes i bëjnë në periudha të ndryshme të ditës (mëngjes, gjatë kalimit të ditës dhe në mbrëmje) në tabelë me tri kolona të përgatitura më parë.
- nxënësit nëpërmjet lojës (me pantomima), u tregojnë të tjerëve se çfarë bëjnë gjatë kohës së lirë. Pasi të tjerët do ta qëllojnë se çfarë bëjnë, grupohen sipas interesit nga ajo që u tha më parë.
- përpunimi i ditarit të fotografive për aktivitete në kohën e lirë sipas ditëve të javës. Secili nxënës zgjedh aktivitete të cilat i bën në kohën e lirë dhe i radhit ato sipas ditëve. Në qoftë se s'ka fotografi nga ajo që bën ai gjatë kohës së lirë atëherë mund të vizatojë edhe vetë.

Tema : **VENDI KU JETOJ**

Gjithsej orë: **8**

Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. thotë emrin dhe të përshkruajë vendin (qytet/fshat) në të cilin jeton, e thotë emrin e shtetit të tij dhe e njëj flamurin shtetëror;
2. përshkruajë përse shërbejnë shitoret/dyqanet, tregu, ambulanca/spitali/ndihma e shpejtë, farmacia, policia, zjarrfikësja dhe i tregon profesionet që ndërlidhen me to;
3. i respekton rregullat themelore të komunikacionit për lëvizje të sigurt në komunikacion.

Nxënësi/nxënësja do të:

4. zhvillojë vetëdije për shtetin e tij përkatës.

Përmbajtje (nacionet)	Standardet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> • Qyteti/fshati dhe shteti im (fshat, qytet, shtet, flamur, shitore/dyqan, treg, ambulanca/spitali, barnatorja, shitës, mjek, infermier, farmacist). 	<ul style="list-style-type: none"> • E thotë emrin dhe e përshkruan vendin në të cilin jeton (qytet/fshat), e thotë emrin e shtetit dhe e njëj flamurin e tij. • numëron lokacionet më të rëndësishme në vendin ku jeton dhe e shpjegon përse shërbejnë (shitorja/dyqani, tregu, ambulanca/spitali, barnatorja etj.). • identifikon profesionet e njerëzve që punojnë në to (shitës, mjek, infermier, farmacist).
<ul style="list-style-type: none"> • I sigurt luaj dhe orientohe në hapësirë (fushë, orientim, majtas-djathtas, para-mbrapa, siguri, rregulla). • I sigurt lëviz dhe jam pjesëmarrës në trafik (rrugë, automjet, këmbësorë, kalim për këmbësorë, trotuar, semafor). 	<ul style="list-style-type: none"> • njëj dhe i përshkruan vendet e sigurt për lojë (fushë, park, oborr...). • dallon vendet e sigurt nga të pasigurtat për luajturi dhe lëvizur. • orientohe në hapësirë: majtas-djathtas dhe para-prapa. • bën dallim midis rrugës, vendkalimit për këmbësorë, trotuarit, udhëkryqit ,shtegut për biçikleta. • njëj disa shenja themelore të komunikacionit dhe semaforin. • përshkruan dhe i krahason lëvizjet e sigurt nga ato të pasigurt në komunikacion (si këmbësorë, si biçikletist, udhëtar në automjet etj.). • parashikon pasojat nga mosrespektimi i rregullave për siguri në komunikacion.
<ul style="list-style-type: none"> • Ndhimja e shpejtë, zjarrfikësja dhe policia (spitali/ambulanca, ndihma e shpejtë/autoambulanca, policia, automjeti i policisë, zjarrfikësit, zjarrfikës...). 	<ul style="list-style-type: none"> • tregon numrat e telefonit të ndihmës së shpejtë, policisë dhe zjarrfikësve. • shpjegon rolet e ndihmës së shpejtë, zjarrfikëses dhe policisë dhe i ndërlidh me situata konkrete.
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p>	
<ul style="list-style-type: none"> • nxënësit (në grupe të vogla) luajnë “mozaik” lojë me bashkim figurash, duke formuar fotografi nga vendi ku jetojnë dhe flamurit të shtetit. • nxënësit zgjedhin fotografi të lokacioneve (shitore, treg, ambulancë, spital, farmaci, park) dhe diskutojnë në grupe përse shërbejnë ato. fotografitë i mbledhin në albumin e titulluar <i>Vendi im ku jetoj</i> i cili plotësohet me vizatimet e bëra nga nxënësit. 	

- mësimdhënësi në listë mësimore ju jep nxënësve hartë në të cilën dallohen disa lokacione të rëndësishme nga vendi ku jetojnë. Nxënësit i pikasin lokacionet më të rëndësishme (shitore,/dyqan, treg, ambulancë/spital, farmaci etj.).
- mësimdhënësi përgatit letra në të cilat janë paraqitur njerëzit me profesione të ndryshme. Secili nxënës zgjedh letër dhe fillon të aktrojë rolin e qëlluar (shitës, mjek, infermiere, farmacist).
- nxënësit tregojnë vende të sigurta dhe të pasigurta për të luajtur dhe pastaj për secilin vend shpjegojnë pse janë të sigurta ose jo.
- mësimdhënësi nëpërmjet video prezantimit tregon vende/lokacione të pasigurta për të luajtur (rrugë, udhëkryq, kantier ndërtimi etj.) dhe pastaj nxënësit në grupe të vogla diskutojnë përse vendi është i pasigurt për të luajtur dhe pastaj secili tregon nga një vend të sigurt për të luajtur (oborr, kënd lojërash, park etj.).
- nxënësit vendosen në dy rreshta. Pastaj njëri nxënës e thotë emrin e një nxënësi tjetër, kurse nxënësi i përmendur duhet të tregojë kush gjendet majtas dhe kush djathtas tij, kush është para dhe kush është prapa tij (në varësi të asaj se në cilin rresht ndodhet nxënësi/nxënësja).
- mësimdhënësi ju prezanton nxënësve (nëpërmjet video prezantimit, me fotografi etj.) lëvizje të sigurt në komunikacion (ecje në trotuar, kalimi i rrugës në vendkalimin për këmbësorë, vozitje të biçikletës në shtegun për biçikleta) dhe pastaj nxënësit tregojnë se si vijnë deri në shkollë, si luajnë në këndin e lojërave dhe si shkojnë tek shoku/shoqja të sigurt.
- nxënësit luajnë dhe simulojnë situata për respektimin/mosrespektimin e rregullave në komunikacion si këmbësorë, udhëtarë, çiklistë për të cilat paraprakisht vetë ato kanë përpunuar disa shenja themelore për siguri (shenja *stop*, shenja për kalim këmbësorësh, shenja se gjendet shkollë afër etj.) dhe semafor nga materiale të ndryshme.
- nxënësit (në grupe) diskutojnë për rolin e policisë, mjekëve, zjarrfikësve dhe për atë se si duket uniforma e tyre, automjetet dhe detyrat e punës që i kanë. Pastaj vizatojnë një situatë rasti për të cilën duhet angazhimi i policisë, i ndihmës së shpejtë dhe i zjarrfikësve dhe me ndihmën e mësimdhënësit e shënojnë në vizatim numrin e telefonit se cila nga këto duhet thirrur (policia, ndihma e shpejtë, zjarrfikësit).
- në klasë vjen si mysafir polic, police, zjarrfikës, dhe/ose infermiere/mjeke, mjek i ndihmës së shpejtë dhe tregojnë raste interesante nga përvoja e tyre e punës. Nxënësit ju parashtrajnë pyetje.

INKLUZIONI, BARAZIA/NDJESHMËRIA GJINORE, INTERKULTURALIZMI DHE INTEGRIMI

Mësimdhënësi siguron inkluzion nëpërmjet kyçjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale nëpërmjet qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënës me aftësi ndryshe, zbaton plan arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të mësimimit dhe të standardeve të vlerësimit) dhe gjithmonë kur është e mundur shfrytëzo mbështetjen nga personat e tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, tutorë voluntarë dhe profesionistë nga qendra shkollore me burime të tilla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e ndjeshme, që të mundet në kohë t'i identifikojë vështirësitë e tyre në të mësuarit dhe t'i inkurajojë dhe mbështesë ata në arritjen e rezultateve të mësimimit.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi i trajton njëlloj si djemtë ashtu edhe vajzat duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipe gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, përpiqet të sigurojë ekuilibër gjinor. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj të cilat në aspekt gjinor dhe etnik/kulturor janë të ndjeshme dhe që inkurajojnë barazinë gjinore, përkatësisht promovojnë interkulturalizëm.

Gjithmonë kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/nocioneve. Integrimi ju mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndë të tjera mësimore, në atë që mësojnë në vetë lëndën dhe kështu të ndërlikojnë njohuritë nga fushat e ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ju mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, në vazhdimësi përcillen aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë mësimimit duke mbledhur informacione për përparimin dhe të arriturat e secilit nxënës. Informata kthyese jepet gjithmonë në vazhdimësi dhe nëpërmjet saj tregohet niveli i suksesit në realizimin e aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësimin (vlerësimi formativ). Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimdhënies për mësimin dhe të mësuarit. Për këtë qëllim mësimdhënësi përcjellë dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit;
- kontributi i aktiviteteve në grup;
- përgjigjet në kuizet që janë pjesë e mësimdhënies;

- kontributi në nxjerrjen e përfundimeve;
- fletët e punës;
- detyrat e shtëpisë;
- realizimi praktik i cili ndërlidhet me standardet e vlerësimit;

Pas përfundimit të mësimit të secilës temë, nxënësit marrin vlerësim përmblendhës duke paraqitur të arriturat sipas standardeve të vlerësimit.

Në bazë të përparimit të konstatuar nëpërmjet teknikave dhe metodave të vlerësimit formativ nxirret vlerësimi përmblendhës i cili i përshkruan të arriturat e nxënësit.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	viti 2021/2022
Institucioni/bartësi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në pajtim me nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit të Arsimit Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimor nga lënda e shoqërisë për klasën e parë	nr. _____ Viti: _____ <div style="text-align: right;"> Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës Milla Carovska _____ </div>